



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alked Kopaçi” (AUTO KOPACI) Person Fizik
Adresa: Njesia Bashkiake nr 7, Rruga e " Kavajes", Pallati nr 102,
Shkalla nr 1, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”- mallra
Referenca e procedurës: Loti II: REF- 22015-05-14-2019
Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti II: Blerje bateri për mjetet e transportit të Bashkisë Tiranë”

Fondi limit loti i dytë: 1.108.334 (një milion e njëqind e tetë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH

Afati i dorëzimit të mallit: Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 27/05/2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 20 datë 20 Maj 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” (AUTO KOPACI) PF NUIS K41510041C
Vlera e ofertës – 777,600 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Klosi –R-Company” shpk NUIS L72120030I

Vlera e ofertës – 821,000 (tetëqind e njëzetë e një mijë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “RA-MI COMPANY” shpk NUIS L61327009F

Vlera e ofertës – 900,000 (nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Kadiu” shpk NUIS J61817045K

Vlera e ofertës – 970,000 (nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Alstezo” shpk NUIS J63208420N

Vlera e ofertës – 926,000 (nëntëqind e njëzetë e gjashtë mijë) **lekë pa TVSH.**

Është s'kualifikuar operatori ekonomik si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik “Alstezo” shpk

1. Operatori ekonomik “Alstezo” shpk është s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“Alstezo” shpk** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik kopje të kërkuar të bilanceve për vitet 2016-2017.

Në dokumentat e tenderit Shtojca 8 ”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ”Kapaciteti ekonomik dhe financiar” (modifikuar nga autoriteti kontraktor), pika 2.2 gërma (c) është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

”Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR”.

Nga verifikimi në S.P.E (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alstezo” rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga operatori ekonomik sa më sipërcituar janë paraqitur:

- 1. Vërtetimi i datës 17.05.2019 me nr 438 Prot lëshuar nga Bashkia Fier, sipas së cilës shoqëria “Alstezo” sha ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019.*
- 2. Vërtetimi i datës 24.05.2019 me nr A-7897/1 Prot lëshuar nga Bashkia Tiranë, sipas së cilës shoqëria “Alstezo” sha ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019.*

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit **“Alstezo” shpk**, në rubrikën *“Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit”* rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitetet dhe është operativ në Dibër (Burrel), Shkodër, Elbasan, Gjirokastër, Korçë etj.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Alstezo” sha nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranës dhe Fierit ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Dibër (Burrel), Bashkinë Korce, Gjirokaster, Elbasan, Shkoder, etj ku ai rezulton të jetë operativ.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, 7 parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

Në vijim në Nenin 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikohet se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.* Në pikën 6 të këtij neni citohet gjithashtu se: “Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Alked Kopaçi” (Auto Kopaçi) Person Fizik**, me adresë: Njesia Bashkiake nr 7, Rruga e "Kavajes", Pallati nr 102, Shkalla nr 1, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **777,600 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH dhe 933.120 (nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzetë) lekë me TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 01.10.2019.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**